

VENDIM
Nr. 201, datë 21.3.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 7, DATË 4.1.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR ARKËTIMIN E TAKSËS SË RENTËS MINERARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 9975, date 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 7, datë 4.1.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit shet për konsum final, brenda vendit, mineralin apo nënproduktin e prodhuar, renta minerare paguhet pranë organit tatimor brenda datës 15 të muajit pasardhës. Vlera që merret parasysht për aplikimin e rentës apo baza e taksueshme, mbi të cilën zbatohet renta, është vlera e deklaruar në faturën e shitjes së mineralit, në rastin e shitjes së mineraleve. Për përcaktimin e detyrimit të rentës, si dokument bazë shërben fatura tatimore me TVSH. Detyrimi për rentën, në rastin kur shitet mineral, përcaktohet duke shumëzuar përqindjen e rentës, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, me vlerën totale të shitjeve. Në rastin e shitjes së produkteve/nënprodukteve që kanë përdorur lëndë të parë pasuri minerale vendase, në bazën e llogaritjes së rentës minerare përfshihet vetëm vlera e mineralit/mineraleve të përdorur për prodhimin e produktit/nënproduktit. Vlera deklarohet nga subjekti, ndërsa autoriteti tatimor ka të drejtë ta krahasojë këtë vlerë të deklaruar me vlerën referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin si lëndë të parë minerale.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit eksporton mineral, renta minerare paguhet në degët doganore, në çastin e bërjes së deklaratës doganore të eksportit, nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, i cili është njëkohësisht dhe eksportues i produktit mineral që eksportohet. Vlera që merret parasysht për aplikimin e rentës apo baza e taksueshme, mbi të cilën aplikohet renta minerare, është vlera e faturës së shitjes së mineraleve, në bazë të çmimeve të eksportit, që është çmimi FOB në Shqipëri. Për përcaktimin e detyrimit të rentës, në këtë rast, si dokument bazë shërben fatura tatimore e shitjes me TVSH zero. Në rastin e eksportit të produkteve/nënprodukteve që kanë përdorur lëndë të parë pasuri minerale vendase, në bazën e llogaritjes së rentës minerare përfshihet vetëm vlera e mineralit/mineraleve të përdorur/a për prodhimin e produktit/nënproduktit. Vlera deklarohet nga subjekti eksportues, ndërsa autoriteti doganor ka të drejtë ta krahasojë këtë vlerë të deklaruar me vlerën referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin si lëndë të parë minerale.”.

3. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Lista me vlerat referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale, hartohet dhe miratohet nga një komision *ad-hoc* i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave. Komisioni, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, drejtorive të përgjithshme të doganave e tatimeve, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

(Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore) dhe Fakultetit të Gjeologji-Minierave, brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ua përcjell zyrtarisht listën e miratuar autoriteteve doganore e tatimore, për t'u përdorur si burim i të dhënave të disponueshme. Ky komision mblidhet dhe përditëson listën sa herë është e nevojshme.”.

4. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe ajo e Tatimeve, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore), Fakulteti i Gjeologji-Minierave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha